VENDIM
Nr.2, datë 11.3.2011

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kritereve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas përqindjeve të mëposhtme:

a) Numri i popullsisë në secilin qark: 35%.

b) Niveli i varfërisë sipas qarqeve: 35%.

c) Përfitimi i investimeve në 4-vitet e fundit sipas sektorëve përkatës: 30%.

2. Përllogaritja e kritereve për formulën e shpërndarjes së fondeve ndërmjet qarqeve, sipas fushave përkatëse, kryhet sipas (shtojcës I) bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Shpërndarja e fondeve ndërmjet qarqeve për secilin sektor sipas aplikimit të formulës është paraqitur në tabelën 1 (shtojca II) bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, pranë Këshillit të Ministrave, kryen rolin e sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve. Sekretariati i përgjithshëm administron dhe përgatit materialet, që do të diskutohen nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Në bazë të kritereve të llogaritura në përputhje me formulën sipas peshës së tyre specifike për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, sekretariati i përgjithshëm i paraqet propozimin Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për ndarjen e fondeve për çdo fushë ndërmjet qarqeve.

6. Aplikimi për fonde bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, universitetet për sektorin e arsimit të lartë dhe bordet e kullimit për sektorin e bujqësisë, duke i dërguar projektet, sipas formatit nr.1 (shtojca III) bashkëlidhur këtij vendimi, në:

- Fondin Shqiptar të Zhvillimit për objektet e infrastrukturës vendore.
- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për objektet e arsimit bazë, të mesëm të përgjithshëm, të mesëm profesional.
- Ministrinë e Shëndetësisë për objektet e kujdesit shëndetësor parësor.
- Ministrinë e Punëve Publike, dhe Transportit për objektet e ujësjellës-kanalizimeve.
- Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për objektet e infrastrukturës së kullim/ujitjes dhe zhvillimit rural duke mbështetur bujqësinë blegtorinë agroindustrinë dhe marketingun.
- Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për objektet e trashëgimisë kulturore, artit dhe kulturës.
- Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për projektet për pyllëzim me dru frutorë.

7. Me fondet e buxhetit të këtij viti do të merren në konsideratë për financim projektpropozimet e reja të paraqitura në vitin 2010-2011 pranë sekretarieteve të institucioneve të përmendura në pikën 5.

8. Vlera e plotë e projekteve, që do të miratohet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, do të jetë ajo e cila është propozuar nga sekretariatet teknike të ministrive të përmendura në pikën 5 dhe dërguar pranë sekretariatit të përgjithshëm të FZHR-së.

9. Për projektet në vazhdim, të papërfunduara, për avancimin e punimeve dhe ende të papaguara, ministritë e linjës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit përgatisin një listë me projektet në

vazhdim, të cilën ia përcjellin sekretariatit të përgjithshëm të FZHR, sipas formatit nr.2 të shtojcës III. Në lidhje me fondin që i akordohet financimit të projekteve në vazhdim, vendimi merret nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, duke mbajtur në konsideratë edhe nivelin real të disbursimeve të përditësuara nga Ministria e Financave.

10. Për aplikimet për projektet e reja, sekretariatet teknike në ministritë e linjës përgatisin metodologjitë përkatëse për të kryer vlerësimin teknik të projekteve, të cilat miratohen me urdhër të ministrit. Një kopje e urdhrit të ministrit depozitohet pranë sekretariatit të përgjithshëm të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

11. Ministritë e linjës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit bëjnë një vlerësim të projekteve sipas kritereve të shtojcës II bashkëlidhur këtij vendimi.

12. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të përmendura në pikën 5 të këtij vendimi, paraqesin pranë sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve listën e plotë të projekteve të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe bordet e kullimit, shoqëruar me vlerësimet ekonomiko-teknike, sipas formatit nr.3 të shtojcës III.

13. Ministria e Brendshme paraqet, pranë sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, përparësitë e zhvillimit dhe të investimeve në nivel vendor sipas fushave përkatëse në përputhje me dokumentet strategjike të zhvillimit të qarqeve, si edhe bazuar në informacionin e marrë nga këshillat e qarqeve, sipas formatit nr.3 të shtojcës III bashkëlidhur.

14. Ministria e Financave përgatit dhe i përcjell, sipas kërkesës, sekretariateve teknike të ministrive të linjës, si edhe sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, analizën dhe vlerësimin për nivelin e mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore për katër vitet e fundit, nga njësitë e qeverisjes vendore.

15. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit përgatitin dhe i përcjellin sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve sasinë e investimeve që këto institucione kanë kryer për katër vitet e fundit të ndarë në nivel qarku sipas rretheve.

16. INSTAT-i siguron të gjitha të dhënat e nevojshme për sekretariatin e përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe institucionet e tjera qendrore, të cilat do të shërbejnë për të analizuar projektet e dërguara për financim.

17. Vendimet e Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, për projektet që do të financohen, përcillen nga sekretariati i përgjithshëm te Ministria e Financave, e cila procedon për veprim, duke çelur fondin e akorduar për investimet sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bazuar në informacionin e marrë nga institucionet buxhetore të përmendura në pikën 5.

18. Monitorimi i ecurisë së zbatimit të punimeve të projekteve dhe i disbursimit të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve do të bëhet nga ministritë përfituese dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Raportet për ecurinë e zbatimit të projekteve të akorduara njësive të qeverisjes vendore nga fondi për zhvillimin e rajoneve do të dërgohen pranë sekretariatit të përgjithshëm të FZHR-së dhe pranë Ministrisë së Financave sipas kërkesës.

19. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, INSTAT-i dhe Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sali Berisha